

TERMA DHE KUSHTE e-POSTA

Termet dhe kushtet që rregullojnë përdorimin e Shërbimit “e-Posta”

Këto janë termat dhe kushtet që rregullojnë përdorimin e Shërbimit “E-Posta” të ofruar nga POSTA SHQIPTARE sh.a. Shërbimi “E-Posta” është i aksesueshëm si aplikacion nga aparatet celular që përdorin sistem operativ iOS apo Android , si edhe gjithashtu nga ueb eposta.postashqiptare.al

DUKE PRANUAR KETO TERMA DHE KUSHTE, JU BINI DAKORD TË VEPRONI NË PËRPTHJE ME TO DHE JU PRANONI SE I KENI LEXUAR, KUPTUAR DHE JENI DAKORD TË VEPRONI NË PËRPTHJE ME TË GJITHA KUSHTET DHE TERMAT KËTU!

Nëse nuk jeni dakord të veproni në përputhje me Kushtet e Termat këtu, ndërmjet jush dhe POSTA SHQIPTARE Sh.A. nuk do të ekzistojë asnjë marrëveshje dhe POSTA SHQIPTARE nuk do të jetë i detyruar t’ju ofrojë Shërbimin **e-Posta** ose Aplikacionin me të gjitha menutë përkatëse të perfshira në të.

POSTA SHQIPTARE Sh.A. rezervon të drejtën për të ndryshuar një apo disa nga kushtet dhe termat këtu, pas një njoftimi të arsyeshëm, përfshirë publikimin e një versioni të ri për Shërbimin.

Ju gjithashtu bini dakord se përdorimi në vazhdimësi nga ana juaj i Shërbimit përbën pranim të kushteve dhe termave, me ndryshimet përkatëse.

Me pranimin e këtyre termave dhe kushteve, ju keni të drejtë të shkarkoni dhe përdorni Aplikacionin e shërbimit e-Posta me të gjitha menutë përkatëse të perfshira në të.

Shkarkimi dhe përdorimi i Aplikacionit të shërbimit e-Posta, së bashku me portalin e-Posta ne vetvete do të jetë pa pagesë, përveç tarifës së aplikueshme për navigimin dhe përdorimin e internetit në varësi të pikës së aksesit Wi-Fi, 3G ose 4G, e cila në vetvete nuk aplikohet apo nuk tarifohet nga Posta Shqiptare Sh.A.

Përkufizime

Termet e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

- **POSTA SHQIPTARE Sh.A. (“POSTA SHQIPTARE”)** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Rr. Reshit Collaku, nr.4 Tiranë,

- **“Aplikacioni”** është Aplikacioni i shërbimit e-Posta shkarkuar nga ana juaj nëpërmjet aparatit tuaj celular nga dyqanet online (Google, Apple). Gjithashtu, në faqen zyrtare të internetit të POSTA SHQIPTARE, do të vendosen lidhje të cilat do ta drejtojnë përdoruesin në dyqanet e mësipërme.
- **Portali** – është website <https://eposta.postashqiptare.al>
- **"Ju/Përdoruesi"** është personi që përdor Shërbimin e-Posta dhe përdor nëpërmjet tij shërbimet e POSTA SHQIPTARE.
- **“Palë”** – Përdoruesi ose POSTA SHQIPTARE sipas rastit.
- **“Palët”** - Përdoruesi dhe POSTA SHQIPTARE
- **“Shërbimi “e-Posta”** është shërbimi që iu mundëson klientëve të POSTA SHQIPTARE të kryejnë online dhe pa qenë nevoja të paraqiten në sportelet e POSTA SHQIPTARE për të kryer pagesa për shërbimet e ndryshme financiare ose postare si psh: gjurmimi i dergesave, pagesat e faturave utilitare, etj.

Të drejtat e Përdorimit

POSTA SHQIPTARE ju jep të drejta jo-ekskluzive për të përdorur Aplikacionin “e-Posta” për aparate celular (iOS apo Andriod) dhe portalin ueb e-Posta (<https://eposta.postashqiptare.al>). POSTA SHQIPTARE nuk mban asnjë përgjegjësi e nuk ka asnjë detyrim, dhe as nuk jep licensa/të drejta për përdorimin e Aplikacioni dhe portalit.

Ju nuk mund të kopjoni, ndryshoni, ndani në pjesë ose zbërtheni Aplikacionin e-Posta, portalin ueb e-Posta apo pjesët e tyre.

Ju nuk mund të transferoni, të kaloni, të jepni me nën-license apo të shpërndani ose t'i lejoni një palë të tretë të përdorë Aplikacionin dhe portalin e-Posta ose një pjesë të tyre. Ju pranoni të mos përdorni Aplikacionin, portalin apo një pjesë të tyre në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme ne fuqi, dhe ndryshimet e tyre kohë pas kohe.

Ju pranoni që Aplikacioni dhe portali, mund të mos jenë të përdorshme për shkak të mospërputhshmërisë së tyre me pajisjen juaj.

Për të përdorur Aplikacionin dhe portalin, Ju duhet të keni konfiguruar më parë celularin tuaj për të mundësuar navigimin në internet. POSTA SHQIPTARE nuk mban përgjegjësi për konfigurime të gabuara, të pasakta, apo mosfunksionim të shërbimit internet për raste jashtë kontrollit dhe përgjegjësisë së POSTA SHQIPTARE.

Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale

Ju nuk përfitoni të drejta të Pronësisë Intelektuale ose të drejta të tjera të lidhura me të, përfshirë patenta, dizenjo, marka tregtare, të drejta të autorit në lidhje me përmbajtjen e Aplikacionit dhe portalit e-Posta.

Ofrimi nga ana e POSTA SHQIPTARE i Aplikacionit dhe portalit E-Posta nuk nënkupton transferimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale të zotëruara nga ana jonë apo nga

ofruesit e liçensuar në lidhje me Aplikacionin dhe portalin, por thjesht lejimin e përdorimit të tyre sipas Kushteve dhe Termave të paracaktuara.

Përdorimi i Aplikacionit dhe portalit E-Posta mbrohet nga legjislacioni përkatës në fushën e Pronësisë Intelektuale.

Ju nuk mund të printoni, kopjoni, riprodhoni, shpërndani, modifikoni ose të publikoni në ndonjë mënyrë tjetër, tërësisht ose pjesërisht, software apo materiale të tjera që ju jepen në lidhje me Aplikacionin dhe portalin E-Posta pa miratimin paraprak me shkrim të POSTA SHQIPTARE.

Përgjegjësia dhe rregullat e përdorimit të Aplikacionit dhe portalit E-Posta

Ju mbani përgjegjësi të plotë për veprimet tuaja në lidhje me të gjitha veprimet që kryeni, përmbajtjen që shkarkoni dhe mënyrën e përdorimit të shërbimit E-Posta, përfshirë ruajtjen e fjalëkalimit dhe aksesin e tij nga palë të treta.

Me përdorimin e Aplikacionit dhe portalit E-Posta, ju merrni përsipër sa më poshtë: Mospërdorimin e Aplikacionit dhe portalit E-Posta për qëllime komerciale. Shërbimi është vetëm për përdorimin personal të pajtimtareve të POSTA SHQIPTARE dhe nuk mund të përdoret për veprimtari tregtare, përveçse kur është miratuar në mënyrë të qartë paraprakisht me shkrim nga POSTA SHQIPTARE.

Nëse dëshironi të përdorni shërbimet e POSTA SHQIPTARE, ju pranoni se: (i) nuk do të riprodhoni Aplikacionin dhe portalin E-Posta (ii) nuk do të kryeni veprime që lidhen me ose shkaktojnë vendosjen e përmbajtjeve me natyrë përçmuese apo keqinformimuese rreth POSTA SHQIPTARE.

Ju jeni në dijeni dhe pranoni se gjatë procedurës së regjistrimit, Ju do të na jepni informacionin personal për numrin e telefonit, adresën e postës elektronike dhe fjalëkalimin e zgjedhur nga Përdoruesi, si edhe që POSTA SHQIPTARE do të mbledhë informacion në lidhje me telefonin tuaj dhe mënyrën e përdorimit të aplikimit/shërbimit, çka është e nevojshme për funksionimin e aplikimit/shërbimit (për shembull, gjuha, pajisja dhe statistikën e përdorimit).

POSTA SHQIPTARE e përdor informacionin e mbledhur me qëllim ofrimin e shërbimit të kërkuar, ofrimin e suportit në rast të ndonjë problemi, për të ofruar mirëmbajtje, si edhe për të optimizuar dhe përmirësuar performancën e shërbimit. POSTA SHQIPTARE e ruan informacionin e mbledhur në mënyrë të sigurt në serverat e POSTA SHQIPTARE, në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

POSTA SHQIPTARE mund t'ju dërgojë komunikime (SMS dhe/ose email-e nga sistemi), përfshirë por pa u kufizuar në konfirmimin e regjistrimit, kujtesat për fjalëkalimet, përditësimet për ndryshimet e bëra shërbimit duke përfshirë njoftimet që ne mund t'ju dërgojmë në lidhje me përdorimin nga ana juaj të shërbimit.

POSTA SHQIPTARE ka të drejtë të përdorë informacionin tuaj për qëllime marketingu vetëm nëse ju keni dhënë pëlqimin tuaj për këtë. Me përdorimin e shërbimit dhe pranimin e këtyre kushteve, ju pranoni përdorimin nga ana e POSTA SHQIPTARE të të dhënave

tuaja si më lart. Në rast se nuk doni që informacioni juaj të përdoret për qëllime marketingu, ju lutem të kontaktoni me një nga mënyrat e shprehura në seksionin “Njsia e Kujdesit të Klientit”.

Kontakt për të dhënat personale.

Ju si përdorues, në cilësinë e subjektit të të dhënave personale, keni të drejtë të kërkonti akses në të dhënat tuaja si edhe të kërkonti që këto të dhëna të korrigoohen apo të përditësohen në përputhje me kërkesat e Ligjit 9887 datë 10.3.2008 «Për mbrojtjen e të dhënave personale», të ndryshuar. Kërkesa mund të drejtohet në cdo dyqan POSTA SHQIPTARE.

Përgjegjësi i Garancive dhe Kufizimi i Përgjegjësisë

Për aq sa lejohet nga ligji i zbatueshëm, Aplikacioni dhe portal E-Posta e ju ofrohet "siç është" pa garanci apo kushte të tjera.

Ne ose ofruesit tanë të licensuar të Aplikacionit dhe portalit nuk do t'ju detyrohemi, përfshirë po pa u kufizuar në: rimbursim, kompensim, dëmet dhe/ose humbje për shkak të humbjes së fitimit aktual apo të ardhshëm, humbjen e të ardhurave, xhiron e shitjeve; humbjen e emrit të mirë, humbjen ose dëmtimin e reputacionit, humbjen e kontratave ose klientëve, humbjen e kursimeve të parashikuara, humbjen ose dëmtimin e të dhënave apo programeve apo për arsye të tjera çfarëdo qofshin, ose indirekte, të veçanta, të rastësishme ose të rëndësishme, qoftë të shkaktuara padrejtësisht (përfshi nga neglizhenca) qoftë për shkak të kontratës, madje edhe në qoftë se ne apo ofruesit tanë të licensuar të Aplikacionit dhe portalit kanë qenë të informuar për mundësinë e humbjeve apo dëmtimeve të tilla.

Njsia e Kujdesit të Klientit

Detajet e kontakteve	Njsia e Kujdesit te Klientit
Telefon	+355 682044727 +355 682044707
E-mail	asistence@postashqiptare.al posta@postashqiptare.com
Platforma e-Posta	Rubrika "ANKESA" ne aplikacionin Mobile ose ne versionin web

Adresa Postare

Drejtoria e përgjithshme Posta Shqiptare
RRUGA: "Reshit Çollaku" nr. 4
Tirana, Albania

Ne vemendje te **Njesise se Kujdesit te Klientit**

Ligji i zbatueshëm dhe Juridiksioni

Këto Kushte dhe Terma për përdorimin e Aplikacionit, Menusë POSTA SHQIPTARE Special dhe Shërbimit Mobile Self Care do të rregullohen dhe interpretohen sipas ligjit shqiptar. Për çdo mosmarrveshje në lidhje me to, Palët angazhohen të zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim. Në rast të kundërt, palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.